



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Konuma e Rahovecit  
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Komuna Rahovec shpall:

---

## Konkurs

### Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

---

<b>Emri i grupit</b>	Specialistë Ligjor
<b>Institucioni</b>	Komuna Rahovec
<b>Nr. i Referencës</b>	RN00012601
<b>Kodi</b>	RPC0006150
<b>Data e njoftimit</b>	21.09.2023
<b>Afati për aplikim</b>	12.10.2023 - 19.10.2023

---



## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

1.Ofron këshilla juridike të rregullta për organet komunale dhe trupave të formuara nga organet komunale (Kryetari i komunës, Kuvendi Komunale, Zyra e prokurimit,Komitetet, Komisionet etj) 2.Përpilon vendime, aktvendime, pëlqime,memorandume mirëkuptimi, kontrata, marrëveshje,leje pune, leje ndërtimi dhe shkresat tjera për organet komunale dhe trupat e formuara nga organet komunale

3.Harton dhe harmonizon aktet juridike nënligjore që bien në kompetencë të komunës si psh. Rregulloret komunale,Vendimet, Urdhëresat administrative etj.

4.Merret me shqyrtimin e ankesave të drejtuara Kryetarit të Komunës dhe drejtorive komunale

5.Ofron këshilla profesionale të interpretimit të akteve juridike për çështjet e parashtruara nga organet komunale dhe trupat e formuara nga organet komunale

6.Kujdeset për ofrimin e mbështetjes profesionale dhe administrative Kryetarit të komunës, drejtorive komunale dhe zyrës së prokurimit.

7.Kujdeset për shqyrtimin, hartimin dhe harmonizimin me kohë të akteve nënligjore dhe të akteve tjera juridike të komunës.

8.Ofron mbështetjen profesionale në udhëheqjen e procedurës administrative për Kryetarin e Komunës dhe drejtorët e drejtorive komunale

9.Me autorizimin e shefit të zyrës ligjore merr pjesë në punët e Kuvendit të Komunës, trupa punuese të kuvendit të komunës dhe të organeve tjera komunale sipas kërkesës zyrtare, për të dhënë mendime profesionale për çështje konkrete nëse kërkohet nga kryesuesi i KK-së dhe Kryetari i Komunës .

## 2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

---

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

## 3. Kërkesat e përgjithshme formale

---

Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve -drejtimi Juridik.

Diplomë e nivelit të pestë të KKK, për profesione deficitare (TIK); Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase;

Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1 (një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.



#### 4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

---

Njohuri të plotë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;

Njohuri të mira metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike dhe në marrjen e vendimeve;

Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;

Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;

Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;

Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

#### 5. Pozitat aktualisht të lira

Kodi	Nr. i Referencës	Titulli i pozitës	Klasa e pozitës	Koeficienti	Institucioni	Organizata / Vendi i punës	Nr. i kërkuar
RPC0005958	RN00012394	Zyrtar Ligjor 2	Profesional 2	4.95	Komuna Rahovec	Zyra ligjore / Zyrtar Ligjor 2	1

#### 6. Mënyra e aplikimit

---

Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

#### 7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

---

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore.
- Kopja e CV.
- Kopja e Leternjoftimit.
- Kopja e dëshmisë së punësimit (Vërtetime dhe Trusti Pensional).
- Kopja e dëshmisë së trajnimit (nëse ka).
- Kopja e certifikatës nën hetime.
- Dëshmi e certifikatës shëndetësore origjinale për kandidatin e suksesëshem(kandidati i cili emërohet ).
- Vërtetim që nuk ju është marrë zotësia për veprim.

#### 8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

---

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë



## 9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

---

- Njohuri të plotë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

## 10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

### Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

